



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 58/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Hasan Shala dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 26.04.2012, mori këtë:

## V E N D I M

**MIRATOHET** ankesa si e bazuar.

Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 2050 (dymijepesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## Arsyetim

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 25.04.2012, nga subjekti politik LVV, me te cilën pretendohet, se me datën 24.04.2012 rreth orës 18:00, në rrugën “Dëshmorët e Kombit” në Ferizaj, gjatë fushatës zgjedhore nga anëtarët e subjektit politik LDK është bërë shkelja e Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit dhe kandidatët e tyre, duke i mbuluar posterat e kandidatit për kryetar të komunës nga radhët e LVV-së Faton Topalli, me postera të subjektit politik LDK.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi disa fotografi.

## Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i, e informoi subjektin politik LDK, më datë 25.04.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 26.04.2012, në ora 12:00, sipas kohës së përcaktuar PZAP-i, nuk ka pranuar përgjigje në ankesë nga subjekti politik LDK.

## **Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike**

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (a) e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Nr.11/2009, parashohin se:

*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:*

*a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik.*

## **Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve**

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

*Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ligji ose rregullave të KQZ-së, mund të:*

*c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).*

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

**ankesa është e bazuar.**

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoi se posterat e subjektit politik LDK, janë të vendosura mbi posterat e kandidat për kryetar komune në Ferizaj, Faton Topalli nga radhët e LVV-së. Prandaj nga arsyet e lartcekura dhe me qëllim të evitimit të shkeljeve të sipërshënuara, po ashtu meqenëse subjekti i njëjtë politik ka përsërit shkeljen e Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit dhe kandidatët e tyre, e mori si rrethanë rënduese për rritjen e dënimit andaj në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

A nr. 58/2012 më datën 26.04.2012

